



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr 31/1 Prot

Tiranë, më 30/06/2021

NJOFTIM

“Për kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë për postin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike”

Kandidatët që do të aplikojnë për postin e Rektorit të Akademisë së Studimeve Albanologjike duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në Nenin 19 dhe Nenin 22, pika 1 dhe 3, të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike” si dhe duhet të paraqesin pranë sekretares së KIZ, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën për kandidim, e cila përmban:
 - emrin;
 - atësinë;
 - mbiemrin;
 - datëlindjen;
 - gjininë;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) kopje të noterizuar të titullit akademik;
- d) dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar, vendin dhe vitet e punësimit.
- e) shprehjen e vullnetit për kandidim;
- f) formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për:
 - deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
 - mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
 - deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
 - deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
 - deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

- g) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet
h) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.

KRYETAR

Hasan Bello

